
C METADAT

Te disa lloje të materialeve janë të disponueshme të dhënat, të cilat përdoren gjatë përgatitjes së regjistrimeve bibliografike. Këto mund të jenë të dhënat për botuesit, por edhe të dhënat nga burime të tjera, p.sh. nga arkivat (repozitorët) akademik.

Të dhënat e këtij lloji grumbullohen në bazën e të dhënave METADAT, dhe nga aty bibliotekat mund t'i shkarkojnë në COBIB. Bibliotekat, të cilat janë të interesuara për përdorimin e këtyre të dhënave gjatë katalogimit, bëjnë marrëveshje me ofertuesin e këtyre të dhënave dhe IZUM-in për shënimin e të dhënave në METADAT.

Ofertuesit duhet të rregullojnë transferin e të dhënave të tyre në METADAT, ndërsa IZUM-i kujdeset për konvertimin në formatin e duhur. Skemat e të dhënave nga burimet e ndryshme ndryshojnë mes vete, për këtë arsye për secilin ofertues duhet të përgatitet konvertim i veçantë.

Të dhënat e ofertuesit të veçantë i shohin vetëm bibliotekat, të cilat katalogojnë materialin e këtij ofertuesi.

Për të hyrë në bazën e të dhënave METADAT duhet autorizimi **CAT_METADAT**.

Në këtë shtojcë është përshkruar baza e të dhënave METADAT, duke vazhduar me përshkrimin e dritares, në të cilën bëhet paraafishimi dhe përzgjedhja e regjistrimit nga baza e të dhënave METADAT dhe procedurat e punës me regjistrimet nga kjo bazë.